



financiare për Bashkinë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



Krijimi i vendeve

të punës për rinjtë



14-20 PRILL
JAVA E MBROJTJES





UZINA E RUBIKUT, QENDËR E PRODHIMIT TË ARMËVE

Uzina e Rubikut do të kthehet në Qendër të Industrisë Ushtarake. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, së bashku me kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Drejtësisë, Ulsi Manja, inspektuan mjediset e saj, ku zhvilluan një bisedë edhe me ish-punonjës të uzinës. Kryeministri tha se, duke zhvilluar këtë industri, nuk rriten vetëm kapacitetet tona mbrojtëse, por përmirësohet ndjeshëm edhe ekonomia vendore dhe kombëtare.

★★★★★



ZËVENDËSMINISTRJA E MBROJTJES, NË TAKIMET E NATO-S

Zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. **Blerina Abrashda**, mori pjesë në **takimet** e nivelit të lartë të ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të **NATO-s**, në Bruksel. Takimet përfshinë Mbledhjen e **Koalicionit** të Vullnetit, si dhe Takimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për **Ukrainën**, ku u diskutua mbi vijimin e **mbështetjes** për Ukrainën dhe hapat drejt një armëpushimi të qëndrueshëm.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Trafikut u nënshkruan marrëveshjet mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Shëndetësisë, duke i hapur rrugë një administrimi të ri, gjithëpërfshirës të akseve tona rrugore.

JM

★★★★★

mod.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

TRUPAT E FD NISEN NË MISION NË DETIN EGJE

Forca Detare/Roja Bregdetare përcolli **Kontingjentin VIII** drejt misionit të NATO-s “**AEGEAN SEA**” në Detin Egje. Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të **FARSH**, gjeneral brigade **Altin Kurti**, në përshëndetjen e tij drejtuar trupave, e konsideroi këtë një ditë të veçantë dhe një moment **krenarie** e përgjegjësie.



STUDENTËT E AFA, NË AKADEMINË USHTARAKE WEST POINT

Dy studente të vitit të tretë të programit “Shkenca Ushtarake” në Akademinë e Forcave të Armatosura morën pjesë në programin e shkëmbimit në Akademinë Ushtarake prestigjioze West Point në SHBA. Gjatë vizitës, ato ndanë eksperiencat e tyre ushtarake me kadetë nga vende të ndryshme të botës dhe morën pjesë në aktivitete akademike dhe kulturore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

DHËNIA E NDIHMËS SË PARË

Efektivë të **Forcës Detare** morën pjesë në trajnimin “Dhënia e Ndihmës së Parë”. Pjesëmarrësit u **trajnuan** mbi teknikat dhe njohuritë **themelore** të ndihmës së parë, me qëllim që të jenë të gatshëm t’u vijnë në ndihmë **kolegëve** në rast nevojë. **Trajnimi** u zhvillua në bashkëpunim me **NAEMT** dhe Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.





VIZITA NË AKADEMINË E AFA

Në kuadër të **aktiviteteve** edukative dhe orientuese për **karrierën**, një grup nxënësish të shkollës së mesme “Nikolla Koperniku”, Elbasan, zhvilluan një vizitë të veçantë në **Akademine** e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, duke u njohur nga afër me këtë **institucion** dhe duke krijuar një ide më të qartë për mundësitë e arsimit të tyre të ardhshëm.

